REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
DREJTORIA E BUJQËSISË, MJEDISIT, MENAXHIMIT TOKËS DHE PYJEVE

Nr. 8262/4 **Prot.** **Divjakë, më:** 14 / 10 /**2026**

PROJEKT-VENDIM

Nr. 91 **, datë** 14 / 10 **/ 2026**

PËR
MIRATIMIN E DHËNIES SË NDIHMËS FINANCIARE Z.ERJON SHEHU, NGA FONDI I KUSHTËZUAR, BANESA E TË CILIT ËSHTË DËMTUAR NGA FATKEQËSI NATYRORE, DUKE ZBATUAR VKB NR.30, DATË 25.07.2022.

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 **"Për Vetëqeverisjen Vendore"** i ndryshuar, në ligjin nr.45/2019 **"Për Mbrojtjen Civile",** neni 7, neni 30, gërma (gj), dhe neni 41, në VKM nr.329, datë 16.05.2012 **"Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore",** në VKM nr.414, datë 8.7.2021 **"Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile"** pika 3.1, gërma (a), Vendimit të Këshillit Bashkiak Divjakë nr.30, datë 25.07.2022 "Për miratimin e akordimit të fondit të kushtëzuar për vitin 2022, në shumën 8,821,291 lekë për familjet, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga një fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera", në shkresën e Prefektit të Qarkut Fier nr.798/1 prot, datë 04.08.2022 "Kthim përgjigje për verifikimin e ligjshmërisë së Vendimit nr.30, të Këshillit të Bashkisë Divjakë, të miratuar në mbledhjen e datës 25.07.2022", i propozojmë Këshillit Bashkiak të Bashkisë Divjakë,

1. Të miratoj dhënien e ndihmës financiare për shtetasin z.Erjon Shehu, banesa e të cilit është dëmtuar nga fatkeqësi natyrore, në mbështetje të Vendimit të Këshillit Bashkiak Divjakë nr.30, datë 25.07.2022 dhe shkresën e Prefektit të Qarkut Fier nr.798/1 prot, datë 04.08.2022.

2.Z.Erjon Shehu t'i akordohet ndihma financiare në masën 50% të vlerës së përllogaritur, e cila është 1.705.428 lekë : 2 = 852.714 lekë, është shuma që do të përfitoj.

3. Burimi i financimit është nga fondi i kushtëzuar për vitin 2026, transferuar nga Ministria e Mbrojtjes, programi "Emergjencat civile", artikulli 604, kodi i produktit 91707AB "shtetas të ndihmuar banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme".

Specialist agronom dhe emergjencave civile
Ferit Qosja

Përgjegjës sektorit juridik, prokurimeve publike dhe menaxhimit të aseteve
Andi Bullari

Drejtori drejtorisë financës dhe buxhetit

Xheladin Brahkola

KRYETARI

Josif GORREA